



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

THIRRJE PËR APLIKIM

Fakulteti Juridik i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), i përkrahur nga Aktiviteti i USAID-it "Drejtësia Vlen" fton studentët e Fakultetit Juridik që të aplikojnë për të qenë pjesë e Klinikës Juridike Penale me raste reale.

RRETH KLINIKËS JURIDIKE PENALE

Klinika Juridike Penale (Klinika) u jep studentëve mundësinë të ndihmojë avokatët e Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) në përfaqësimin pro bono të të pandehurve me gjendje ekonomike të rëndë në rastet penale. Studentët pjesëmarrës do të kenë mundësi të përjetojnë zbatimin e mësimëve akademike në praktikë duke punuar në çështjet penale reale gjatë vitit të katërt të Fakultetit Juridik (apo të programit Master, drejtimi Penal). Ligjëratat e klinikës do të mbahen në hapësirat e Fakultetit Juridik, ndërsa aktivitetet e përfaqësimit të klientëve (këshillimi dhe avokimi) do të mbahen në zyrat e avokatëve të OAK dhe, sipas nevojës, në gjykatë apo prokurori. Studentët klinikë do të takohen një herë në javë për ligjeratë dhe diskutime në tryezë të rrumbullakët rreth procedurës penale. Ligjëratat do të mbahen nga ligjerues të ftuar të cilët janë profesionistë ligjorë (prokurorë, avokatë dhe gjyqtarë), përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile, etj. Përveç ligjeratave, studentët do të punojnë në ekipe për të ndihmuar avokatët që ata të përfaqësojnë klientët në gjykatë dhe në të gjitha fazat përgatitore të çështjeve penale pa pagesë. Studentët aktivë të Klinikës, pritet që të ndajnë përvojën e tyre të klinikës me nxënësit e shkollave të mesme përmes aktiviteteve të partnerëve në kuadër të Aktivitetit "Drejtësia Vlen".

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E STUDENTËVE

Çdo student (nën mbikëqyrjen e një avokati të OAK-së), do të angazhohet në një gamë të plotë të detyrave të avokatit:

- Intervistimi dhe këshillimi i klientit
- Përgatitja dhe argumentimi i mbrojtjes;
- Shqyrtimi i të dhënave, provave etj;
- Hulimtim i ligjit për të siguruar mbështetje për teoritë e ndryshme ligjore;
- Asistimi në hartimin dhe paraqitjen e shkresave të ndryshme;
- Të marrin pjesë në ligjerata një herë në javë;
- Të marrin pjesë në dhënien e ligjeratave në shkolla të mesme që realizohen nga partnerët e Aktivitetit "Drejtësia Vlen".

KËRKESAT PËR STUDENTËT

Për të qenë pjesë e Klinikës, Studentët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jenë studentë të vitit të tretë, katërt të Fakultetit Juridik ose kandidat për Master në drejtimin Penal në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti";
- Zotërojnë aftësi të shkrimit ligjor;
- Zotërojnë aftësi të hulimtit ligjor;
- Aftësi për të dhënë këshilla ligjore për klientët;
- Të demonstrojnë interes në reformën gjyqësore, angazhim në komunitetin, dhe qasje në drejtësi;
- Të demonstrojnë angazhim për etikë në klinikë;
- Të mos ketë qenë pjesë e Klinikës Juridike Penale në të kaluarën;

APLIKONI

Për të aplikuar klikoni këtë [link](#) dhe plotësoni të dhënat e kërkuara. Afati i fundit për Aplikim është **21 shkurt 2020** në ora **24:00**. Për çdo pyetje, ju lutem dërgoni email në dekanati.jur@uni-prizren.com ose info@ncsc-ks.org

Për shkak të numrit të madh të kandidatëve, vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.

RRETH AKTIVITETIT "DREJTËSIA VLEN"

Aktiviteti "Drejtësia Vlen" ka për qëllim përmirësimin e qasjes në drejtësi për të gjithë, përfshirë grupet e pafavorizuara dhe të marginalizuara, duke forcuar sistemet dhe ofrimin e informatave mbi ndihmën juridike falas. Aktiviteti "Drejtësia Vlen" është një program tre vjeçar që financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe përmes këtij konkursi do të mbështesë rritjen e mundësive për formim të të menduarit kritik dhe aftësive praktike të studentëve.